

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I PARË

VENDIM

Ankimet nr. 15373/15 dhe 3604/16

**Qazim Çela kundër Shqipërisë
dhe Albi Petrela kundër Shqipërisë**

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Parë), e mbledhur më 18 tetor 2016, si një Komitet i përbërë nga:

Kristina Pardalos, *presidente*

Robert Spano,

Pauliine Koskelo, *gjykatës,*

dhe Renata Degener, *zëvendëssekretare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh ankimet e mësipërme, dorëzuar respektivisht më 24 mars 2015 dhe 27 korrik 2012,

Duke pasur parasysh deklaratat formale në të cilat pranohet një zgjidhje miqësore e çështjeve,

Pasi ka diskutuar, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Në shtojcë gjendet një listë me ankuesit.

Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjentja e saj znj. A. Hicka, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

Ankuesit ngritën pretendimet në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, në referencë edhe të nenit 13 të Konventës, për kohëzgjatjen e procedimeve civile dhe administrative të ndërmarra respektivisht.

Për sa i përket ankimit nr. 15373/15, në datën 13 qershor dhe 20 shtator 2016, Gjykata mori deklaratë për zgjidhje miqësore të nënshkruara nga palët, sipas të cilave ankuesi hiqte dorë nga ngritja e pretendimeve të mëtejshme kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që ngrinin këtë ankim kundër sipërmarrjes së Qeverisë për t'i paguar atij 4,400 EUR (katër mijë e katërqind euro) për të mbuluar çdo dëm jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet.

Në lidhje me ankimin nr. 3604/16, më 27 korrik dhe 20 shtator 2016, Gjykata mori deklaratë për zgjidhje miqësore të nënshkruara nga palët, sipas të cilave ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga ngritja e pretendimeve të tjera kundër Shqipërisë në lidhje me faktet që ngrinin këtë ankim kundër sipërmarrjes së Qeverisë për t'i paguar atij 4,700 EUR (katër mijë e shtatëqind euro) për të mbuluar çdo dëm jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet.

Sipas deklaratave për zgjidhje miqësore, shumat e mësipërme do të konvertohen në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të përjashtohen nga çdo taksë që mund të jetë e zbatueshme. Ato do të paguhën brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se këto shuma nuk paguhën brenda periudhës së përcaktuar prej tre muajsh, Qeveria do të marrë përsipër të paguajë interesin e thjeshtë mbi to, nga përfundimi i asaj periudhe deri në kompensim, në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së vonesës së pagesës plus pikë tre përqindëshe. Pagesat e mësipërme do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Gjykata merr në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo sigurohet se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe në protokollet e saj dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar një shqyrtim të mëtejshëm të ankimit. Në lidhje me sa më sipër, është me vend që çështjet të hiqen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t'i bashkojë ankimet;

Vendos t'i heqë ankimet nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.
Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 10 nëntor 2016.

Renata Degener
Zëvendëssekretare

Kristina Pardalos
Presidente

SHTOJCË

Ankimi nr. 15373/15

Qazim ÇELA është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1952, i cili jeton në Tiranë dhe u përfaqësua nga R. METAJ.

Ankimi nr. 3604/16

Albi PETRELA është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1969, i cili jeton në Tiranë.

GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

DEKLARATË

ECHR-LE16.0aG

YP/EME/mlb

ÇËSHTJA ÇELA KUNDËR SHQIPËRISË (Ankimi nr. 15373/15)

Unë deklaroj se Qeveria e Shqipërisë ka ofruar t'i paguajë *ex gratia* 4,400 EUR Qazim Çelës, me qëllimin për të siguruar një zgjidhje miqësore për çështjen e sipërpërmendur e mbetur pezull përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të mbuluar të gjithë dëmin jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet plus ndonjë taksë e cila mund t'i tariforet ankuesit.

Kjo shumë do të konvertohet në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata për ta përjashtuar çështjen nga lista e saj e çështjeve. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës së përcaktuar prej tre muajsh, Qeveria do të marrë përsipër të paguajë interes të thjeshtë mbi të, nga përfundimi i asaj periudhe deri në kompensim në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së vonesës së pagesës plus pikë trepërqindëshe. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Për Qeverinë

(emri) (firmosur) (vendi) *Tiranë* (data) *19.09.2016*